

RIPARIM ASFALTI NE RRUGEN MARTA BUDA, DURRES

RELACIONI PËRSHKRUES DHE SPECIFIKIME TEKNIKE



Rruga “Marta Buda” ndodhet midis Zjarrefikeses dhe markates se Durresit. Kjo rruge eshte pjeserisht e amortizuar. Rruga perballet me fluks te madh levizjesh te automjeteve gjate dites. Ne fotot e mesiperme shohim qarte gjendjen e rruges ne pjese te ndryshme gjate saj. Kordinatat e ketij segmenti sipas Asig Gjeoportaj Albanian Gaus-Kuger jane:

fillimi i rruges	fundi i rruges
4370598.313	4370477.617
4577521.881	4577535.315

- Frezimi i rruges.

Frezimi do te kryhet ne te gjithë gjatesine dhe gjeresine e rruges se mbetur deri te kuneta. Do te frezohet pjesa asfaltike ekzistuese ne thellesin 3-4 cm, ne menyre qe mbas hedhjes se asfaltit te ri te ruhen kuotat dhe rakordimet me kunetat.

- Shtrese asfalti.

Ne kete ze eshte parashikur sperkatja me bitum $1\sim 2\text{litra}/\text{m}^2$, transporti, shtrimi me makineri dhe ngjeshja me rrul. Shtresa e asfaltit te kete trashesine pas rrulimit 4 cm. Materialet e prodhimit te jene brenda standarteve.

Provat merren per çdo 500m^2 asfalt te shtruar me mostra 25×25 dhe provohen ne laborator per treguesit fiziko-mekanik te cilat duhet te jene brenda kerkesave te STASH 660-87.

Gjate zbatimit ne shtrimin e shtresave asfaltike te merret parasysh kerkesat teknike

dhe te mbahen akt kontrolli teknik ku te pasqyrohen te gjitha te dhenat nga pamja,matjet laboratike. Shtresa e asfaltit te kete trashesine pas ngjeshjes 4 cm.

Gjate asfaltimit te rruges te behet kujdes ne lidhjen e asfaltit te ri me betonin me ngjyre ne vendkalimin e kembesoreve. Pjesa e betonuar e cila ngrihet mbi nivelin e asfaltit ekzstues nga 0-13 cm, te mbulohet gjate procesit te hedhjes se prajmerit dhe asfaltit, ne menyre qe te shmaget demtimi i shtreses se betonit.



Ortofoto e rruges " Marta Buda" .

Ark. Adnand Tocila

Ark. Adlei Likmeta

Ing. Eni Turkeshi

